

Vendim nr.52 datë 01.12.2011

(V-52/11)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Bashkim Dedja, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Vitore Tusha, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, me sekretare Blerina Çinari, në datën 26.04. 2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 10, 17, 18 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË; GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET; GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Arjeta Çefa dhe Bledar Miloti, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

O B J E K T I: Shpallja si të papajtueshme me nenet 16/1, 17, 19, 20 dhe 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të:

- termit “kombësi”, të përcaktuar në nenin 6/1 dhe 8;
- termit “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve”, të përcaktuar në nenin 42/2, germa “e”;
- nenit 58, tërësisht,

të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/1, 17, 19, 20, 35, 124, 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin, subjektet e interesuara, Kuvendin e Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datën 03.02.2011, është paraqitur për shqyrtim padia me paditës V.K. dhe V.K., me objekt “deklarimin e pavlefshëm të lindjeve në lidhje me përbërësin e kombësisë së paditësve, duke kryer ndryshimin e përbërësit të kombësisë nga ‘shqiptare’ në ‘greke’, duke qenë se është në kundërshtim me ligjin dhe duke qenë se është dëshira jonë”.

2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, në datën 08.02.2011, është paraqitur për shqyrtim padia me paditës K.P., me objekt “deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të fletës familjare të regjistrit të vitit 1950-1974, të përbërësit ‘kombësi’ që i përket K.P. dhe rregullimin e pasojave në regjistrat përkatës”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 23.02.2011, ka marrë në shqyrtim çështjen civile me paditës A.P., me objekt “ndryshimin e ‘kombësisë’ nga ‘shqiptare’ në ‘malazeze’”.

4. Nga marrja në shqyrtim e padive të mësipërme, të tria gjykatat (bashkërisht “gjykatat referuese”) kanë konstatuar se ligji nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” (në vijim “ligji për gjendjen civile”) është i papajtueshëm me Kushtetutën, në disa dispozita të tij, dhe në zbatim të nenit 145/2 të Kushtetutës, kanë pezulluar shqyrtimin e çështjeve dhe i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”).

5. Më konkretisht, kërkuesit kanë parashtruar se termi “*kombësi*”, i përcaktuar në nenin 6/1 dhe 8; termi “*kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve*”, i përcaktuar në nenin 42/2, germa “e” dhe neni 58 i ligjit për gjendjen civile, janë të papajtueshëm me nenet 16/1, 17, 19, 20 dhe 35 të Kushtetutës.

6. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 1, pika 2, të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje dhe me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vendosi bashkimin e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura nga gjykatat referuese, për shkak të objektit dhe pretendimeve në thelb të njëjta.

7. **Gjykatat referuese**, në kërkesën e tyre kanë parashtruar se:

7.1. Në të drejtën ndërkombëtare publike, termi “kombësi” nuk trajtohet si nocion juridik, por si përkatësi etnike. Për këtë arsye, kombësia nuk passjell të drejta dhe detyrime për individin dhe nuk është e rëndësishme për të individualizuar të drejtat e tij në aspektin familjar.

7.2. Në bazë të parashikimeve të nenit 20 të Kushtetutës, shteti nuk duhet të ndërhyjë duke vendosur detyrim ligjor për personat që u përkasin pakicave kombëtare që të shprehin përkatësinë e tyre etnike. Personat që ju përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar, as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Me ligjin për gjendjen civile, elementi “kombësi” është përcaktuar si element përbërës i gjendjes civile të një shtetasi shqiptar, duke detyruar çdo shtetas shqiptar të deklarojë kombësinë e tij, që do të evidentohet në regjistrat e gjendjes civile.

7.3. Zgjedhja e ligjvënësit për të njohur kombësinë si element përbërës të gjendjes civile, në rrethanat kur më parë nuk kishte një rregullim ligjor lidhur me mënyrën e përcaktimit dhe pasqyrimin të saj në aktet e gjendjes civile, jo vetëm që është i papajtueshëm me nenin 20 të Kushtetutës, por krijon një pamundësi objektive për zbatimin e këtij kriteri ligjor, duke pasur parasysh se ligji civil nuk ka fuqi prapavepruese për të rregulluar një marrëdhënie juridike që nuk ka qenë më parë e rregulluar me ligj.

7.4. E drejta e përkatësisë etnike, ashtu si dhe e drejta e përkatësisë fetare, trajtohen tashmë në kuadrin e të Drejtave të Njeriut si të drejta që lidhen me jetën private të individit. Nëse, në kuptim të nenit 20/2 dhe 24 të Kushtetutës, ashtu sikurse është pranuar tashmë nga jurisprudenca, qytetarët nuk mund të detyrohen të deklarojnë të dhëna mbi përkatësinë e tyre fetare, në të njëjtën mënyrë ata nuk mund të detyrohen të deklarojnë të dhëna mbi përkatësinë e tyre etnike, kulturore dhe gjuhësore dhe çdo ligj që merr përsipër të vendosë një detyrim të tillë, është antikushtetues.

7.5. Ligji për gjendjen civile krijon pabarazi në trajtimin e shtetasve që kanë lindur përpara hyrjes në fuqi të tij, të cilëve, përpara ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, *i shfuqizuar*, nuk iu përcaktohej asnjë kombësi e përkohshme por vetëm kombësi e përhershme, dhe atyre që kanë lindur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, edhe pse mund të jenë në kushte absolutisht të barabarta, si p.sh. fëmijë të prindërve të njëjtë. Shtetasit që kanë lindur përpara hyrjes në fuqi të ligjit për gjendjen civile dhe atij të shfuqizuar të vitit 2002, nuk kanë asnjë mundësi të provojnë përpara gjykatës pretendimet e tyre, pasi ata nuk kanë një kombësi të përkohshme, ndërsa ata të lindur pas hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2002, të cilët kanë një kombësi të shënuar të përkohshme, nuk kanë asnjë detyrim për të provuar kombësinë e tyre pasi mund të

zgjedhin secilën nga kombësitë e prindërve. Pabarazia në trajtim, duke mos i dhënë të drejtën e zgjedhjes së kombësisë disa individëve vetëm për shkak se ata kanë lindur përpara hyrjes në fuqi të ligjit për gjendjen civile dhe mungesa në ligj e trajtimit të situatës së këtyre subjekteve, është antikushtetuese, në bazë të nenit 18 dhe 20 të Kushtetutës.

7.6. Në nenin 42/2, germa “e”, të ligjit për gjendjen civile, ku flitet për regjistrimin e lindjes së një fëmije, termi “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve” nuk i përgjigjet edhe rastit kur fëmija ka lindur nga prindër me kombësi të ndryshme, gjë që në mungesë të marrëveshjes midis tyre, cenon interesat e palës tjetër.

7.7. Sipas nenit 58/1 të ligjit për gjendjen civile, shprehja “kur sipas ligjit vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve” lejon çdo fëmijë madhor, edhe pas vdekjes së prindërve, të kërkojë vërtetimin e pasaktësisë së kombësisë së prindërve, në kundërshtim me sa kanë shprehur vullnetin ata kur kanë qenë gjallë. E drejta e shprehjes së lirë të çdo individi në moshë madhore për të vërtetuar pasaktësinë e kombësisë së prindërve, pa e provuar një vullnet të tillë të kundërt, cenon lirinë e shprehjes lidhur me përkatësinë etnike.

8. Subjekti i interesuar, **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare prapësimet e tij në këto drejtime kryesore:

8.1. Kërkuesit nuk legjitimohen për t’iu drejtuar Gjykatës për shpalljen e antikushtetutshmërisë së dispozitave ligjore, për arsye se nuk jemi në kushtet e kontrollit incidental; edhe pse ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjeve konkrete, kontrolli për antikushtetutshmëri nuk përbën zgjidhje për çështjet konkrete.

8.2. Termi “kombësi” është futur në dispozita ligjore vetëm me ndryshimet që ju bënë ligjit të mëparshëm nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i shfuqizuar. Përfshirja e këtij termi ishte shprehje e vullnetit politik të ligjvënësit dhe rrjedhojë e detyrimeve që i linden shtetit shqiptar nga ratifikimi i Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve¹. Një pjesë e mirë e dispozitave të ligjit të mëparshëm janë bërë pjesë e ligjit për gjendjen civile, pa ndryshime.

8.3. Asnjë dispozitë e ligjit për gjendjen civile nuk detyron dhe as ndalon pakicat kombëtare të shprehen lirisht për përkatësinë etnike, ndaj nuk kemi cenim të nenit 20 të Kushtetutës.

¹ Kuvendi i Shqipërisë në datën 03.06.1999 ka miratuar ligjin nr. 8496, “Për ratifikimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve”

8.4. Termi “kombësi”, si element i gjendjes civile, nuk përbën detyrim për deklarim.

8.5. Ligji për gjendjen civile nuk ka fuqi prapavepruese.

8.6. Në kuadër të së drejtës së informimit, shtetasit kanë të drejtë të japin dhe marrin informacion edhe në lidhje me kombësinë. Ndërhyrja apo kufizimi i jetës private, në formën e dhënies së informacionit mbi kombësinë, është bërë me ligj, në përputhje me nenin 17 dhe 35 të Kushtetutës, duke pasur parasysh se ligji për gjendjen civile i shërben forcimit të shtetit ligjor.

9. Subjekti i interesuar, **Këshilli i Ministrave**, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare prapësimet e tij në këto drejtime kryesore:

9.1 Kërkuesit nuk legjitimohen në lidhje me kërkimin për antikushtetutshmëri të neneve 6, 8 dhe 42 të ligjit për gjendjen civile sepse nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis këtyre dispozitave dhe zgjidhjes së çështjes.

9.2 Të dhënat mbi përbërjen etnike të popullsisë i shërbejnë identifikimit, mbrojtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të identitetit të pakicave kombëtare, duke pasur parasysh se shteti, mbi bazën e këtyre të dhënave, përmbush detyrimin që të garantojë arsimimin e pakicave kombëtare në gjuhën e tyre amtare.

9.3 Ligji për gjendjen civile, në tërësinë e tij, nuk ka vendosur asnjë detyrim për individin që të deklarojë përkatësinë e tij kombëtare dhe nuk parashikon sanksione në rast se nuk plotësohet përbërësi “kombësia”. Rrjedhimisht, është e dukshme se neni 20 i Kushtetutës respektohet.

9.4 Kombësia njihet nga legjislacioni shqiptar që nga viti 2003 dhe ligji për gjendjen civile i parashikon të gjitha modalitetet për zbatimin e parashikimeve ligjore të bëra në të.

9.5 Neni 3 i ligjit për gjendjen civile e njeh “karakterin personal” të të dhënave mbi kombësinë.

9.6 Trajtimi i shtetasve që kanë lindur përpara hyrjes në fuqi të ligjit për gjendjen civile, dhe atyre që kanë lindur pas hyrjes në fuqi të tij, është i barabartë.

II

Për legjitimimin e gjykatave referuese

10. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë ngritur pretendimin se gjykatat referuese nuk legjitimohen për t’iu drejtuar Gjykatës në lidhje me kërkimin për antikushtetutshmëri të neneve përkatëse, objekt i këtij kontrolli kushtetues. Neni

145, pika 2, i Kushtetutës parashikon të drejtën e gjyqtarëve, që në çdo fazë të gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këto raste, gjyqtarët pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, gjyqtari ose gjykata, gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht, ose me kërkesë të palëve, kur çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t’u shprehur mbi kushtetutshmërinë e ligjit.

11. Gjykata është shprehur në vazhdimësi për aspektet e legjitimitetit të gjykatave, të cilat e vënë në lëvizje atë nëpërmjet kontrollit incidental. Sipas Gjykatës, “...*Së pari*, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; *së dyti*, duhet të parashtojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës”(vendimi nr. 2, datë 03.02.2010, i Gjykatës Kushtetuese). Gjykata në jurisprndencën e saj, ka theksuar gjithashtu se “...gjykata ose gjyqtari duhet të sqarojë me kujdes lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete” (vendimi nr. 5, datë 06.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Duke shtjelluar më tej këtë konotacion, Gjykata ka pohuar se “... në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë, duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo Gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimit incidental, në kuptimin që, gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese” (vendimi nr. 13, datë 04.05.2009, i Gjykatës Kushtetuese).

12. Në rastin konkret, gjykatat referuese kanë konstatuar se palët ankuese, duke u bazuar tek ligji për gjendjen civile, objekt shqyrtimi, kanë kërkuar ndryshimin e përbërësit “kombësi” në regjistrat e gjendjes civile. Nisur nga ky konstatim, gjykatat referuese kanë çmuar se dispozitat ligjore përkatëse, të zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve konkrete, bien ndesh me parimin kushtetues të mosdetyrimit për të shprehur përkatësinë etnike, të sanksionuar në nenin 20 të Kushtetutës dhe parimin e mosdetyrimit për të bërë publike të dhëna personale, të parashikuar në nenin 35 të Kushtetutës. Në vlerësimin e Gjykatës, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet

çështjes objekt gjykimi dhe kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore, për të cilat kërkohet të ushtrohet kontrolli kushtetues.

13. Për sa më sipër, Gjykata çmon se, gjykatat referuese legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe i konsideron si të pabaza pretendimet e subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitetit të kërkuesve.

III

Gjykata, në shqyrtimin e çështjes, do të kontrollojë nëse dispozitat ligjore që kundërshtohen, përkatësisht:

- termi “kombësia”, i përcaktuar në nenin 6/1 të ligjit për gjendjen civile, ku parashikohet: *“Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, kombësia, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj”*

- termi “kombësia”, i përcaktuar në nenin 8 të ligjit për gjendjen civile ku parashikohet: *“Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë, kombësia dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë”*

- termi “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve”, i përcaktuar në nenin 42/2, germa “e”, të ligjit për gjendjen civile, ku parashikohet: *“Akti i lindjes përmban (....) kombësinë, në përputhje me kombësinë e prindërve;*

- neni 58 i ligjit për gjendjen civile, ku parashikohen mënyrat e përcaktimit dhe ndryshimit të elementit “kombësi”,
cenojnë parimet kushtetuese të parashikuara në nenet 20 dhe 35 të Kushtetutës.

A. Për konceptin “kombësi”

14. Gjykatat referuese pretendojnë se ligji për gjendjen civile, duke përcaktuar elementin “kombësi”, si element përbërës të gjendjes civile, dhe duke rregulluar mënyrën e regjistrimit të këtij elementi në regjistrat e gjendjes civile, detyron çdo shtetas shqiptar të deklarojë kombësinë e tij, në kundërshtim me parimin e mosdetyrimit të shprehjes së përkatësisë etnike, sipas nenit 20 të Kushtetutës.

15. Në funksion të ushtrimit të kontrollit kushtetues, Gjykata e shih të nevojshme të vlerësojë fillimisht kuptimin e nocioneve “kombësi” dhe “pakicë kombëtare” dhe më pas të fokusohet tek çështja nëse ka apo jo cenim të nenit 20 të Kushtetutës.

16. Mosekzistenca e një përkufizimi të përbashkët për konceptin “komb” është tashmë një fakt i njohur dhe i pranuar në doktrinën e së drejtës². Pavarësisht se termi komb është i rrënjësuar në kulturën dhe historinë e popujve dhe përfshin elementë themelorë të identitetit të tyre, modelet përkufizuese të këtij nocioni mbeten në një masë të madhe arbitrare. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (në vijim “Asambleja Parlamentare”) është shprehur në Rezolutën 1735 (2006) se “..ajo është e ndërgjegjshme për nevojën e sqarimit të terminologjisë së përdorur, në kushtetuta dhe legjislacione në fuqi, mbi fenomenin e lidhjeve etnike, gjuhësore dhe kulturore ndërmjet grupeve të qytetarëve që jetojnë në shtete të ndryshme, e në veçanti të përdorimit të fjalës “komb” në një kontekst specifik historik ose politik”. Asambleja Parlamentare pranon se në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, koncepti “kombësi” përdoret për të treguar shtetësinë, e cila përfaqëson një lidhje juridike ndërmjet shtetit dhe individit, pavarësisht nga origjina etno-kulturore e tij, ndërsa në disa shtete të tjerë, termi “kombësi” përdoret për të treguar një komunitet organik që flet një gjuhë të caktuar dhe karakterizohet nga një sërë traditash të ngjashme kulturore dhe historike, nga perceptime të ngjashme të së shkuarës, aspirata të ngjashme për të tashmen dhe të ardhmen. Në këndvështrimin e Asamblesë Parlamentare, aty ku koncepti “kombësi” do të thotë shtetësi, nënkuptohet një lloj marrëdhënieje kontraktuale ndërmjet një personi fizik dhe një shteti, ndërsa në vendet ku koncepti “kombësi” do të thotë komunitet etno-kulturore ai nënkupton një realitet kulturor (një fakt ose status kulturor) që bazohet në bashkimin e lirë dhe të njëanshëm të një personi fizik me atë komunitet dhe përfshin vetëm marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të komunitetit (*përkthim i Gjykatës*)³.

17. Duke pasur parasysh mënyrën se si u krijuan shtetet “komb” gjatë shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të, si edhe për shkak të ndryshimeve të kufijve të shteteve ‘komb’ në fund të luftës së Dytë Botërore dhe në fund të Luftës së Ftohtë, në territoret e pothuaj gjithë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës jetojnë grupe të ndryshme njerëzish, të cilët janë shtetas të të njëjtit shtet, por i përkasin pakicave të ndryshme kulturore. Në krahasim me grupin më të madh të qytetarëve me të njëjtën përkatësi etnike-kulturore, këto grupe, të cilat janë relativisht

² Shih Rezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës nr. 1335 (2003).

³ Shih Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës nr. 1735, 26 janar 2006

më të vogla, përbëjnë të ashtuquajturat pakica kombëtare. Edhe për pakicat kombëtare nuk ka një përkufizim të pranuar universalisht. Formulimi që ka konsensusin më të gjerë në doktrinën juridike, e përcakton një pakicë kombëtare si një grup numerikisht më të ulët, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë së një shteti, në një pozitë jo-dominante, pjesëtarët e të cilit – duke qenë edhe shtetas të atij shteti - kanë karakteristika etnike, fetare ose gjuhësore të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të popullsisë dhe tregojnë, qoftë dhe në mënyrë të nënkuptuar, një ndjenjë solidariteti të drejtuar drejt ruajtjes së kulturës, traditave, fesë apo gjuhës⁴(*përkthim i Gjykatës*). Ky lloj përkufizimi përfshin si kriteret objektive ashtu dhe kriteret subjektive, të cilët janë të ndërruar me njëri-tjetrin. Sipas studiuesve të doktrinës juridike, grupi duhet të plotësojë karakteristikat objektive që e dallojnë atë nga pjesa tjetër e popullsisë, siç janë numri, historia, gjuha, feja, dhe jodominimi. Ndërsa komponenti subjektiv ka të bëjë me vetëperceptimin e grupit si të dallueshëm nga të tjerët, dhe dëshirën e anëtarëve individualë të grupit për të identifikuar veten e tyre së bashku si një grup.

18. Kushtetuta shqiptare nuk ka një përkufizim të qartë për termin “kombësi” apo termin “pakicë kombëtare”, edhe pse këto terma janë të përfshirë në dispozita kushtetuese. Gjykata vëren gjithashtu edhe mungesën e akteve të tjera ligjore apo nënligjore që përmbajnë rregullime në lidhje me termat “kombësi”, “pakicë etnike” apo “pakicë kombëtare”. Për herë të parë termi “kombësi” përmendet në ligjin nr. 8950, 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, *i shfuqizuar*, por pa u përkufizuar si term. Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe termi “komb” përkufizohet si “një bashkësi e qëndrueshme njerëzish e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës”. Ndërsa termi “kombësi” përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish që i paraprin kombit e që është formuar historikisht gjatë shthurjes së marrëdhënieve fisnore në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit e të kulturës, e cila ka ardhur duke u zhvilluar e duke u forcuar”. “Përkatësia etnike” ose e thënë ndryshe “etnia”, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në një truall të caktuar e cila ka një gjuhë dhe kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë”. Gjykata nënvizon, në këtë këndvështrim, se edhe ligji për gjendjen civile, dispozitat e të cilit janë objekt shqyrtimi, nuk përcakton saktësisht dhe qartësisht se çfarë kuptohet me termin “kombësi”.

⁴ Ky formulim është propozuar nga Francesco Capotorti, Raportuesi Special i Nën-Komisionit mbi Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave të OKB-së, në Studimin për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Etnike, Fetare dhe Gjuhësore

19. Konstatimet e mësipërme Gjykata do t'i mbajë parasysh në vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore, objekt i këtij kontrolli kushtetues.

20. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata sjell në vëmendje dhe rëndësinë e respektimit të parimit të sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se: “vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme” (*vendimi nr. 9, datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese*). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*vendimi nr. 36, datë 15.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për pretendimin e papajtueshmërisë së termit “kombësia”, në nenin 6/1 dhe 8; termit “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve” në nenin 42/2, germa “e” dhe nenit 58 të ligjit për gjendjen civile, me nenin 20 të Kushtetutës.

21. Një ndër parimet themelore të shtetit të së drejtës, në kuadrin kushtetues, është respekti ndaj të drejtave të pakicave, që jo vetëm nxit kohezionin social, por ndihmon dhe në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme, të integruar e multidimensionale, ku të drejtat e njeriut garantojnë për të gjithë. Neni 20 i Kushtetutës, parashikon se “*personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre*”. I marrë në tërësi, ky nen synon të garantojë të drejtat e pakicave kombëtare, në mënyrë që ato të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e shprehura në Kushtetutë, të zbatueshme për këdo dhe njëkohësisht, të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor e fetar. Qëllimi i kushtetutëbërësit është që, në shoqërinë shqiptare, të gjithë të jetojnë së bashku në harmoni, duke njohur vlerat në ndryshimet e dallimet kulturore që karakterizojnë

pakicat kombëtare. Në paragrafin e parë të tij, neni 20 i Kushtetutës parashikon të drejtën e ushtrimit nga pakicat kombëtare të të drejtave dhe lirive të tyre, në barazi të plotë para ligjit. Parimi i trajtimit të barabartë të personave që i përkasin një pakice me pjesën tjetër të popullsisë së një shteti, e cila përbën shumicën, përbën një garanci kushtetuese dhe një qasje me parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës. Paragrafi i dytë i nenit 20, shprehet për deklarimin lirisht, pa u ndaluar, as detyruar, nga personat që i përkasin pakicave kombëtare, të përkatësisë së tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Kushtetutëbërësi ka zgjedhur, siç duket qartë nga gjuha e këtij formulimi, që të sanksionojë në këtë paragraf, një parim mjaft të rëndësishëm, që është ai i mosdetyrimit të personave që ju përkasin pakicave kombëtare për të deklaruar përkatësinë e tyre etnike. Ky parim i mosdetyrimit është një garanci kushtetuese, për sa i përket të drejtës për të deklaruar ose jo disa përkatësi të veçanta që karakterizojnë pakicat kombëtare dhe lidhet ngushtësisht me mbrojtjen e autonomisë personale të individit. Në një shoqëri demokratike, mbrojtja e jetës private dhe respektimi i garancive në këtë drejtim janë thelbësore.

22. Ligji për gjendjen civile, objekt i këtij kontrolli kushtetues, është i aplikueshëm për të gjitha kategoritë e individëve që jetojnë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe pakicat kombëtare (neni 1). Nisur nga ky fakt, Gjykata çmon se ligji për gjendjen civile bie në sferën e parashikimit të nenit 20 të Kushtetutës.

23. Në rastin në shqyrtim, dispozitat ligjore që kundërshtohen si antikushtetuese janë përkatësisht nenet 6/1, 8, 42/2, germa ‘e’ dhe 58 të ligjit për gjendjen civile. Neni 6/1 përcakton se: “përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, *kombësia*, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj”. Ndërsa neni 8 rregullon njohjen, heqjen, shuarjen, ndryshimin ose kalimin e disa prej përbërësve të gjendjes civile, duke parashikuar se: “lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë, *kombësia* dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë”. Sipas nenit 42/2 germa “e”, “akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë dhe deklaruesi. Ai përmban: (...) *kombësinë, në përputhje me kombësinë e prindërve*”. Përcaktimi i elementit “kombësi”, në kuptim të ligjit për gjendjen civile, për nevojat e regjistrimit, rregullohet nga neni 58, sipas të cilit “1. *Fëmija merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë, të dokumentuar në*

Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur, sipas ligjit, vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve, ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndryshimin e atësisë apo të amësisë. Ndryshimi i kombësisë, në çdo rast, bëhet me vendim gjyqësor; 2. Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, fëmijës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ose në rast vdekjeje të njërit prej tyre, shërbimi i gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të fëmijës atë të të atit. Kombësia e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës madhor; 3. Fëmija e lindur jashtë martese, kur nuk dihet atësia, merr kombësinë e nënës. Kjo kombësi mund të ndryshojë me vërtetimin e atësisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni; 4. Fëmija me prindër të panjohur, i lindur në Shqipëri, presumohet me kombësi shqiptare. Kur njëri ose të dy prindërit gjenden ose kur fëmija arrin moshën madhore, për kombësinë e tij zbatohen përcaktimet e pikës 2 të këtij neni; 5. I birësuari merr kombësinë e birësuesve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, por kur ai arrin në moshë madhore, ka të drejtë të rimarrë kombësinë që kishte para birësimit, ose ta ndryshojë atë, sipas kombësisë që kanë prindërit biologjikë; 6. I linduri me fekondim artificial nga një grua e martuar merr kombësinë e njërit prej bashkëshortëve, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni; 7. Ndryshimi i kombësisë bëhet në rastet e përcaktuara në këtë ligj vetëm me vendim gjyqësor, duke u thirrur, në çdo rast, si palë në proces shërbimi i gjendjes civile, edhe kur kombësia ka qenë caktuar përkohësisht ose kur është bërë një gabim material; 8. Ndryshimi i kombësisë shqiptare të shtetasve shqiptarë nga organe të huaja është absolutisht i pavlefshëm”.

24. Duke marrë në konsideratë tërësinë e këtyre dispozitave dhe lidhjen që ekziston midis tyre, Gjykata vëren se ky ligj, duke përfshirë elementin “kombësi” si përbërës të gjendjes civile, krahas përbërësve të tjerë, si dhe duke përcaktuar kriteret objektive që rregullojnë regjistrimin e kësaj të dhëne nga punonjësit e gjendjes civile, kërkon deklarimin e kombësisë në mënyrë të detyrueshme, ku nënkuptohet njëkohësisht dhe përkatësia etnike, si aspekt/element i kombësisë. Konkretisht, sipas ligjit për gjendjen civile, kombësia e një individi të sapolindur, në kushtet e pamundësisë objektive të zgjedhjes nga ana e tij për ta shprehur ose jo, është subjekt i deklarimit të prindërve, bazuar në marrëveshjen mes tyre. Neni 58 i ligjit për gjendjen civile rregullon rastet e mosmarrëveshjes si dhe rastet e tjera për përcaktimin e kombësisë së individit, në funksion të regjistrimit të këtij komponenti në regjistrat e gjendjes civile. Kështu, në kushtet kur vetëdeklarimi i fëmijës është objektivisht i

pamundur dhe mungon deklarimi i prindit/prindërve, kategoria “kombësi” nuk mbetet e paplotësuar në regjistra, por nëpunësi i gjendjes civile e plotëson në përputhje me dispozitat ligjore për gjendjen civile. Sipas këtij arsyetimi, ligji për gjendjen civile e bën të detyrueshëm pasqyrimin e të dhënave për përkatësinë etnike të individit në aktet dhe regjistrat e gjendjes civile. Në vlerësimin e Gjykatës, parimi i mosdetyrimit për të bërë publike përkatësinë etnike, që përshkon nenin 20 të Kushtetutës, nënkupton shprehjen lirisht të vullnetit të një individi të caktuar për të deklaruar ose jo përkatësinë e tij etnike. Kjo do të thotë që në mungesë të deklarimit, për çfarëdo lloj arsye, qoftë objektive apo subjektive, ligji për gjendjen civile duhet të respektojë lirinë individuale të zgjedhjes për të mos bërë publike përkatësinë etnike. Nëpërmjet dispozitave lejuese, ligji për gjendjen civile i ka dhënë kompetenca nëpunësit të gjendjes civile për të plotësuar përbërësin “kombësi” në kushtet e mungesës së deklarimit, duke krijuar kështu një konflikt me parimin e rëndësishëm të mosdetyrimit për të shprehur përkatësinë etnike, të përcaktuar në nenin 20 të Kushtetutës.

25. Parimi i zgjedhjes së lirë për të shprehur ose jo përkatësinë etnike dhe lidhjen me një identitet kombëtar, inkurajohet edhe në të Drejtën Ndërkombëtare. Në aspektin e përgjithshëm, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në nenin 14, ndalon, *inter alia*, diskriminimin në bazë të “(...) origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësisë në një pakicë kombëtare(...)”. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve (në vijim ‘Konventa Kuadër’), e ratifikuar nga Shqipëria, në nenin 3 të saj parashikon të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare të zgjedhë ose të trajtohet ose të mos trajtohet si i tillë. Sipas Raportit Shpjegues të Konventës, ky nen, në paragrafin 1, i garanton, së pari, çdo personi që i përket një pakice kombëtare, lirinë për të zgjedhur për t’u trajtuar ose jo si i tillë. Kjo dispozitë e lë çdo person të tillë të vendosë nëse dëshiron të bëhet subjekt i mbrojtjes që ofron Konventa Kuadër. Ky paragraf nuk nënkupton një të drejtë të individit për të zgjedhur në mënyrë arbitrare përkatësinë në ndonjë pakicë kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është e lidhur pazgjidhshmërisht me kritere objektive të rëndësishme për identitetin e personit. Sipas këtij paragrafi, asnjë dëm nuk duhet të rezultojë nga garantimi i kësaj zgjedhjeje të lirë, apo nga ushtrimi i të drejtave të cilat janë të lidhura me këtë zgjedhje (*shih §33-36 të Raportit Shpjegues të Konventës Kuadër; përkthimi i Gjykatës*). Në vlerësimin e Gjykatës, shprehja “që i përket një pakice kombëtare” do të thotë që Konventa e sheh anëtarësinë në një pakicë në një këndvështrim substancial dhe jo vetëm si markë apo si etiketë, ose zgjedhje të imponuar ndaj individit. Nisur nga këndvështrimi i mësipërm, Gjykata vëren se neni 20 i Kushtetutës, në harmoni të plotë me

standardet referuese ndërkombëtare, parashikon qartësisht se deklarimi i përkatësisë etnike mund të jetë vetëm i vullnetshëm dhe fryt i një zgjedhjeje të lirë të individit për ta shprehur atë ose jo.

26. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, pretendon se përfshirja e elementit “kombësi” në regjistrat e gjendjes civile, i shërben identifikimit, mbrojtjes së të drejtave dhe zhvillimit të mëtejshëm të pakicave kombëtare, duke pasur parasysh se shteti, mbi bazën e këtyre të dhënave, përmbush detyrimin që të garantojë arsimimin e pakicave kombëtare në gjuhën e tyre amtare. Gjykata, në funksion të këtyre pretendimeve të Këshillit të Ministrave, e konsideron të rëndësishme të ndalet tek racionalja e përfshirjes së termit “kombësi” në ligjin për gjendjen civile. Ligji për gjendjen civile rregullon funksionimin e një sistemi, nëpërmjet të cilit qeveria identifikon qytetarët/shtetasit e vet dhe personat e tjerë rezidentë në shtetin në fjalë, si dhe ngjarjet më të rëndësishme në jetën e tyre. Kombet e Bashkuara e përkufizojnë gjendjen civile si “regjistrim i vazhdueshëm, i qëndrueshëm, i detyrueshëm dhe universal i ndodhive dhe karakteristikave të ngjarjeve jetike të popullsisë, përmes një dekreti ose rregulloreje, në përputhje me kërkesat ligjore në një shtet. Regjistrat e gjendjes civile janë edhe një burim kryesor për statistika jetësore dhe përfshijnë lindjet e gjalla, vdekjen, martesën, divorcin, anulimin e martesës, birësimin, vendbanimin”⁵ (*përkthimi i Gjykatës*). Objekti i ligjit për gjendjen civile, i shprehur në nenin 1 të tij, është: “kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë”. “Gjendja civile” përkufizohet si “tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre”. “Përbërës të gjendjes civile”, sipas nenit 2/4 të ligjit, janë “të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj apo çdo personi pa shtetësi me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë”. Elementet e gjendjes civile kanë një rëndësi të veçantë për shtetin, jo vetëm sepse identifikojnë individin, si i tillë, por edhe sepse identifikojnë ngjarje thelbësore të jetës së tij, të cilat prodhojnë pasoja juridike në marrëdhëniet e individit me shtetin. Në

⁵ ‘Handbooks on Civil Registration and Vital Statistics Systems, Policies and Protocols for the Release and Archiving of Individual Records’, Series F, No. 70, United Nations, New York, 1998

momentin që këto ngjarje (siç janë martesë, divorci, vdekja) regjistrohen në regjistrat e gjendjes civile, ato prodhojnë efekte juridike, në formën e të drejtave dhe detyrimeve, në aspektin e raportit individ/shtet. Duke e përfshirë elementin “kombësi” në përbërësit e gjendjes civile, legjislatori automatikisht i ka dhënë atij një kuptim jetik, duke e klasifikuar si një komponent të domosdoshëm në aktet e gjendjes civile. Në vlerësimin e Gjykatës, “kombësia” si koncept i papërkufizuar, në ndryshim nga komponentët e tjerë të gjendjes civile, nuk krijon një lidhje juridike që përket në të drejta dhe detyra të ndërsjellta të personit fizik dhe shtetit shqiptar. Gjykata i konsideron të pabazuara pretendimet e Këshillit të Ministrave dhe çmon se ligji për gjendjen civile nuk mund të jetë i vetmi burim i identifikimit të pakicave kombëtare. Në këtë drejtim, nuk mund të mos merren parasysh parashikime të tjera, regjistrime të mëparshme, apo të dhëna historike, të cilat gjenerojnë informacion që i shërben identifikimit të pakicave kombëtare dhe politikave shtetërore për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre pakicave.

27. Bazuar në vlerësimet e bëra më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se termi “kombësi”, i përcaktuar në nenin 6/1 dhe 8; termi “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve”, i përcaktuar në nenin 42/2, germa “e”, dhe neni 58 i ligjit për gjendjen civile, bien në kundërshtim me nenin 20 të Kushtetutës dhe parimin e sigurisë juridike.

C. Për pretendimin e papajtueshmërisë së termit “kombësia”, në nenin 6/1 dhe 8, termit “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve”, në nenin 42/2, germa “e” dhe neni 58 të ligjit për gjendjen civile me nenin 35 të Kushtetutës, në lidhje me të dhënat personale

28. Gjykatat referuese pretendojnë se identiteti etnik i një individi duhet të konsiderohet si një e dhënë që i përket jetës së tij private. Mbrojtja e jetës private dhe familjare, në Kushtetutë, bëhet përmes disa dispozitave, veçanërisht nga neni 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe fshehtësia e korrespondencës), neni 37 (paprekshmëria e banesës), neni 53 (mbrojtja e martesës dhe familjes), etj. Parimi i ruajtjes së të dhënave personale, si një aspekt i jetës private, garantohet nga neni 35 i Kushtetutës. Ky nen parashikon, ndër të tjera, në paragrafin e parë se: “askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij”.

29. Për çështjen në gjykim, Gjykata çmon paraprakisht rëndësinë e veçantë që kanë të dhënat mbi përkatësinë etnike, të cilat i takojnë sferës private të individit dhe si të tilla

klasifikohen si të dhëna personale. Veçoria që i dallon të dhënat mbi përkatësinë etnike nga moria e të dhënave personale është karakteri “sensitiv” i tyre, që del në pah duke pasur parasysh potencialin e mundshëm për ndarje dhe diskriminim shoqëror që ato mbartin. Të dhënat “etnike” mund të bëhen shkak për paragjykitime etnike, krijimin e kategorive “etnike” në statistika zyrtare, që tentojnë të forcojnë disa identitete të caktuara etnike, ndarje në shtresat sociale apo përdorimin e informacionit për qëllime jolegjitime. Për rrjedhojë, mbledhja e të dhënave mbi përkatësinë etnike, duke i përfshirë ato në akte dhe regjistra zyrtare, duhet të bëhet në respektim të garancive të veçanta për përpunimin e tyre.

30. Parimi i mosdetyrimit të bërjes publike të të dhënave personale, siç është sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës, përbën një garanci kushtetuese. Legjislatori, në respektim të këtij parimi kushtetues, ka miratuar Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”(në vijim ‘ligji për të dhënat personale’). Gjykata e sheh të arsyeshme të ndalet, në vijim, në disa parashikime të rëndësishme të këtij ligji. Parimi kryesor i ligjit për të dhënat personale është se përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private. Në nenin 3/1 të tij sqarohet kuptimi i të dhënave personale që konsistojnë në “çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm. Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj”. Njëkohësisht, jepet dhe përkufizimi i të dhënave “sensitive”, ku përfshihet “çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose *etnike*, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale” (neni 3/2). Përpunimi i të dhënave është “çdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike, me të dhënat personale, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çfarëdo veprim tjetër, si dhe transmetimi i të dhënave” (neni 3/7). Sipas nenit 7, “ndalohet përpunimi i të dhënave, që zbulojnë origjinën racore ose *etnike*, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin dhe jetën seksuale, të dhëna të cilat përpunohen vetëm nëse: a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave; b) është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet; c) autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një

interes të rëndësishëm publik; ç) lidhet me të dhëna që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave, ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore; d) të dhënat përpunohen për kërkime shkencore ose statistikore; dh) të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor, sigurimit të kujdesit shëndetësor, kurimit, menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përdorimi i tyre kryhet nga personeli mjekësor ose persona të tjerë, që kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë; e) të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk i bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj; ë) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës”. Siç vërehet nga këto parashikime ligjore, të dhënat personale “sensitive”, ku përfshihet dhe përkatësia etnike, gëzojnë një mbrojtje të veçantë për shkak të karakterit të tyre privat.

31. Gjykata, në jurisprudencën e saj, në një analizë të nenit 8 të KEDNJ-së, që lidhet me respektimin e jetës private, është shprehur se “formulimi i nenit 8, (...) evidenton jo vetëm detyrimin negativ të autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t’i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të tre pushteteve; ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (...) Respektimi i jetës private kërkon, në parim, mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij. Padyshim që, edhe në këtë rast, në parim, qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ka qenë pikërisht garantimi i asaj hapësire të nevojshme brenda së cilës, individi, do të mund të zhvillonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në çdo rast konkret, legjitimiteti ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha, duhet pasur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime apo sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private” (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Mbrojtja e jetës private, e parashikuar në nenin 8 të KEDNJ-së përfshin mbrojtjen e autonomisë personale dhe mbrojtjen e të dhënave sensitive të një individi. Në këndvështrim të garancive që ofron neni 8, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është shprehur

se “autonomia personale është një parim i rëndësishëm, i cili nënvizon garancitë për mbrojtjen e jetës private dhe që i jep mbrojtje sferës personale të secilit individ, përfshi të drejtën për të dhënë detaje të identitetit të tyre si qenie njerëzore” (shih *çështjet Burghartz kundër Zvicrës*, 22 shkurt 1994; *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 11 korrik 2002). E drejta e respektimit të jetës private ka disa aspekte plotësuese siç janë ruajtja e “sferës private rreth individit”, e cila përfshin “të drejtën për një jetë private sociale”, “të drejtën e individit për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me personat e tjerë të të njëjtit grup” (shih *Niemietz kundër Gjermanisë*, 16 dhjetor 1992), “të drejtën për të mbrojtur të dhënat personale” (shih *Rotaru kundër Rumanisë*, 4 Maj 2000) dhe “të drejtën për autonomi personale” (shih *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 29 prill 2002). Sipas GJEDNJ-së, identiteti etnik është një e dhënë që lidhet me identitetin e individit dhe që bie në fushën e veprimit të nenit 8 të KEDNJ-së për mbrojtjen e jetës private (shih *S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 4 dhjetor 2008). Duke nënvizuar natyrën “sensitive” të të dhënave mbi përkatësinë etnike, GJEDNJ-ja pohon se identiteti etnik i individit, ashtu si emri, gjinia, feja dhe orientimi seksual, përbën një aspekt thelbësor të jetës së tij private dhe identitetit të tij (shih *Ciubotaru kundër Moldavisë*, 27 prill 2010).

33. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se ligji për gjendjen civile, nuk parashikon garanci për sa i përket marrjes, mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale “sensitive”. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk i referohet, në mënyrë eksplicite dhe konkrete, ligjit për të dhënat personale. Në këtë aspekt, Gjykata e konsideron si thelbësore ekzistencën e një dispozite specifike referuese për shkak të natyrës “sensitive” të të dhënave mbi përkatësinë etnike. Gjykata vë në dukje se ligji për gjendjen civile nuk përmban as parashikime se si do të përdoren këto të dhëna apo mbi përgjegjësinë në rast keqpërdorimi të tyre, gjë e cila do të përbënte një garanci mjaft të rëndësishme për të gjithë shtetasit.

34. Nisur nga kjo premisë, Gjykata arrin në konkluzionin se, dispozitat e ligjit për gjendjen civile, objekt i këtij kontrolli kushtetues, duke vendosur detyrimin për regjistrimin e të dhënave mbi ‘kombësinë’ në regjistrat e gjendjes civile, ndërhyjnë në sferën e jetës private të individit, në kuptim të nenit 35 të Kushtetutës. Kjo ndërhyrje, në vlerësimin e Gjykatës, shkakton një devijim nga parimi kushtetues i mosdetyrimit të bërjes publike të të dhënave personale, ku përfshihen dhe të dhënat personale “sensitive”, i cili sanksionohet në nenin 35 të Kushtetutës. Gjykata çmon se mbrojtja e të dhënave “sensitive”, si një nga komponentët e së drejtës për respektimin e jetës private, garantohet nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit për të bërë publike

ose jo këto lloj të dhënash, në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës. Të dhënat që sigurojnë informacion për analiza demografike, të nevojshme për zhvillim ekonomik dhe social apo për qëllime të politikave shtetërore për të nxitur ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të pakicave etnike, mund të merren nëpërmjet procedurave të tjera përkatëse, në përputhje me garancitë ligjore që parandalojnë shpërdorimin e të dhënave të mbledhura, si dhe përcaktojnë saktësisht rregullat e veçanta të përpunimit.

35. Bazuar në çka më sipër, Gjykata çmon se rregullimet e ligjit për gjendjen civile, objekt shqyrtimi, cenojnë garancitë e nenit 35 të Kushtetutës.

36. Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se termi “kombësi”, i përcaktuar në nenin 6/1 dhe 8; termi “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve”, i përcaktuar në nenin 42/2, germa “e”, dhe neni 58 i ligjit për gjendjen civile, cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe bien në kundërshtim me nenet 20 dhe 35 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, germa “a” dhe nenit 134, pika 1, germa “d” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të termit “kombësi” në nenet 6/1, 8, 42/2, germa “e” dhe të nenit 58, tërësisht, të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët në pakicë, jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e dispozitave të kundërshtuara si të papajtueshme me Kushtetutën, për arsye se mendojmë se kërkesa duhej rrëzuar për shkak të moslegjitimitit të gjykatave referuese për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

2. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtari i zakonshëm, kur çmon se ligji (apo dispozita të tij) vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit/dispozitave të tij.

3. Neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka përcaktuar kushtet që duhet të respektojë gjyqtari i zakonshëm për të iniciuar gjykimin incidental: së pari gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor, duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti gjykata/gjyqtari duhet të parashtojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se duhet të ketë një raport të domosdoshëm midis vendimit të saj (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjyqtari, subjekt iniciues i gjyqimit incidental, në kuptimin që gjykimi në gjykatën e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimet nr.13, datë 04.05.2009 dhe nr.2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Për këtë qëllim, gjykata/gjyqtari, para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës. Pra, duhet të çmojë se ligji që vlerëson si jokushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete. Në të kundërt, nëse gjykata/gjyqtari çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr.5, datë 06.03.2009; nr.13, datë 04.05.2009 dhe nr.30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Ne, gjyqtarët në pakicë, vërejmë se Gjykatës i janë drejtuar me kërkesë për kontroll incidental tre gjykata, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Para secilës prej këtyre gjykatave

ishte paraqitur për shqyrtim një padi me objekt ndryshimin e përbërësit kombësi në regjistrin e gjendjes civile, nga shqiptare në greke në dy gjykimet e para dhe nga shqiptare në malazeze në gjykimin e tretë. Secila prej gjykatave ka pezulluar gjykimin dhe i është drejtuar Gjykatës me tre kërkesa të veçanta, me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të termit “kombësi” në nenet 6/1, 8, 42/2, shkronja “e” dhe të nenit 58 tërësisht, të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

6. Në lidhje me legjitimitimin e gjykatave referuese, shumica shprehet në vendimin e saj se, në rastin konkret, këto gjykata kanë konstatuar se palët ankuese, duke u bazuar tek ligji për gjendjen civile, objekt shqyrtimi, kanë kërkuar ndryshimin e përbërësit “kombësi” në regjistrat e gjendjes civile. Nisur nga ky konstatim, gjykatat referuese kanë çmuar se dispozitat ligjore përkatëse, të zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve konkrete, bien ndesh me parimin kushtetues të mosdetyrimit për të shprehur përkatësinë etnike, të sanksionuar në nenin 20 të Kushtetutës dhe parimin e mosdetyrimit për të bërë publike të dhëna personale, të parashikuar në nenin 35 të Kushtetutës. Në vlerësimin e Gjykatës ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet çështjes objekt gjykimi dhe kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore, për të cilat kërkohet të ushtrohet kontrolli kushtetues. Për sa më sipër, shumica ka vlerësuar se gjykatat referuese legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën.

7. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se shumica nuk është ndalur siç duhet në verifikimin e elementeve procedurale që duhet të plotësojë kërkesa për iniciimin e gjyimit incidental, në kundërshtim me jurisprudencën e kësaj Gjykate, të sipërcituar. Bazuar në kërkesat e paraqitura para Gjykatës, rezulton se ligji i zbatueshëm nga gjyqtarët referues, për t’i dhënë zgjidhje padive të ngritura nga shtetasit, është vetëm neni 58, paragrafët 1, 2 dhe 7, të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, që përcakton mënyrën e fitimit dhe kushtet e ndryshimit të kombësisë. Bazuar në këtë nen: *1. Fëmija merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë, të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur, sipas ligjit, vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve, ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndryshimin e atësisë apo të amësisë. Ndryshimi i kombësisë, në çdo rast, bëhet me vendim gjyqësor. 2. Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, fëmijës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ose në rast vdekjeje të njërit prej tyre, shërbimi i gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të fëmijës atë të të atit. Kombësia e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit*

prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës madhor... 7. Ndryshimi i kombësisë bëhet në rastet e përcaktuara në këtë ligj vetëm me vendim gjyqësor, duke u thirrur, në çdo rast, si palë në proces shërbimi i gjendjes civile, edhe kur kombësia ka qenë caktuar përkohësisht ose kur është bërë një gabim material.

8. Për sa më sipër, në gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesat nuk plotësojnë kushtin e parë, atë të identifikimit të ligjit që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhja e drejtpërdrejtë). Ligji i zbatueshëm prej gjykatave referuese në rastet konkrete është vetëm neni 58 i ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, kurse dispozitat e tjera të kundërshtuara prej tyre nuk janë të zbatueshme për t’i dhënë zgjidhje këtyre çështjeve konkrete.

9. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjykimi incidental kërkon edhe raportin e domosdoshëm midis vendimit të kësaj Gjykate (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Në këtë funksion ajo duhet të argumentojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, se në një gjykim incidental, gjykata referuese, nëse arrin në konkluzionin se ligji/dispozitat e kundërshtuara janë ligji i vetëm të cilit duhet t’i referohet për zgjidhjen e çështjes, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, ajo duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr.12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Të individualizosh çështjen do të thotë mbi të gjitha të interpretosh dispozitën e ligjit: funksioni interpretues si i tillë nuk i takon kësaj Gjykate, por gjykatës referuese. Është detyrimi i kësaj të fundit të zgjidhë dyshimet interpretative duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t’i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës së individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret.

10. Për sa më sipër ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se në rastin konkret, kushti i ekzistencës së raportit midis vendimit të Gjykatës dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nuk plotësohet nga gjyqtarët referues për asnjërën nga dispozitat e kundërshtuara para Gjykatës. Përfundimi i gjykimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të kundërshtuara nuk i jep zgjidhje çështjeve konkrete të pezulluara. Çështjet konkrete, të paraqitura për zgjidhje para gjykatave

referuese, në thelb të tyre, përfaqësojnë pikërisht të drejtën e individit, shtetas shqiptar, i cili pretendon se i përket pakicave kombëtare, dhe këtë fakt juridik, me vullnetin e tij, dëshiron ta pasqyrojë në aktet e gjendjes civile si të dhënë të identitetit të tij. Paditë para gjykatës janë ngritur pikërisht nga këta individë dhe pezullimi i çështjeve përkatëse nga gjykatat dhe ngritja e çështjes së kushtetutshmërisë pengon këta shtetas në ushtrimin e kësaj të drejte, në kundërshtim me nenin 20 të Kushtetutës. Po ashtu, ne vlerësojmë, gjithashtu, se nuk është plotësuar edhe kushti tjetër i interpretimit të normës në përputhje me Kushtetutën. Nga ana e gjykatave referuese nuk është bërë asnjë përpjekje për të interpretuar normat e kundërshtuara në përputhje me parimin kushtetues të sanksionuar në nenin 20 të Kushtetutes, që është pretenduar prej tyre se është cenuar.

11. Ligji nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, ka parashikuar specifikisht, mes të tjerash, edhe mënyrën e fitimit të kombësisë, regjistrimin e saj në rast mosmarrëveshesh mes prindërve me kombësi të ndryshme (si rast për ndryshimin e kombësisë), si dhe rastet e tjera kur ajo mund të ndryshohet, vetëm sipas përcaktimeve të nenit 58 të këtij ligji. Ndryshimi i kombësisë bëhet, në rastet e përcaktuara në këtë normë, vetëm me vendim gjyqësor. Në rast se në praktikë gjykata të ndryshme kanë zbatuar në mënyrë të ndryshme apo edhe abuzive këto dispozita, kjo nuk përbën çështje për këtë Gjykatë, pasi mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

Në mbështetje të argumenteve të parashtruara më sipër, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se gjykatat referuese nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje këtë gjykim incidental.

Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha